

Bëhu anëtar në Unia!

Përmirësimet në KKP-në e re shkojnë në drejtimin e duhur. Mirëpo ju keni merituar edhe më shumë! Për të shënuar edhe më shumë rezultate, je i nevojshëm edhe ti! Vetëm së bashku ne mund të arrijmë më shumë. Bëhu anëtar i Unia dhe angazhohu për paga të mira dhe kushte më të mira pune.



Kontrata Kolektive e Punës (KKP)

Falë KKP ti ke kushte më të mira pune se sa me ligj. Për shembull, një pagë të 13-të mujore, pagë të garantuar minimale dhe ditë të paguara festash. Sepse KKP do të ketë vetëm atëherë, kur shumë punonjës pastrimi janë në sindikatë. Ti ke nevojë për sindikatë - sindikata ka nevojë për ty.



Këshillim dhe mbrojtje juridike

Nëse punëdhënësi yt nuk ta paguan me korrektësi pagën tënde të 13-të mujore, apo nëse të largon ty nga puna gjatë shtatzënisë - Unia është në shërbim tënd! Për çdo vit ne nxjerrim rreth 12 milionë franga kompensim për anëtarët tanë.



Rimbursimi

Si anëtar i Unia ti merr prapa kontributin tënd profesional, që punëdhënësi yt ta heq nga rroga. Një herë në vit ti merr një formular nga ne, me të cilin ti mund të kërkossh kthimin e këtyre parave.



Trajnimi

Anëtarëve tanë ne u ofrojmë trajnime të shumta përmes institutit arsimor „Movendo“. Për çdo vit ti mund të ndjekësh një kurs falas (përfshi ushqimin dhe fjetjen). Ne pos tjerash ty ti paguajmë deri në 1000 franga për trajnimin tënd profesional.

Anëtarësohu tani.
Skano tani kodin QR.



Së bashku jemi më të fortë!

Unia në afërsinë tënde

Unia Aargau-Nordwestschweiz

0848 11 33 44 ag-nws@unia.ch

Unia Bern/Oberaargau-Emmental

031 385 22 22 bern@unia.ch

Unia Berner Oberland

033 225 30 20 thun@unia.ch

Unia Biel-Seeland/Solothurn

032 329 33 33 biel@unia.ch

Unia Fribourg

026 347 31 31 fribourg@unia.ch

Unia Genève

0848 949 120 geneve@unia.ch

Unia Neuchâtel

0848 20 30 90 neuchatel@unia.ch

Unia Oberwallis

027 948 12 80 oberwallis@unia.ch

Unia Ostschweiz-Graubünden

0848 750 751 ostschweiz-graubuenden@unia.ch

Unia Ticino

091 821 10 40 ticino@unia.ch

Unia Transjurane

0848 421 600 transjurane@unia.ch

Unia Valais

027 602 60 00 valais@unia.ch

Unia Vaud

0848 606 606 vaud@unia.ch

Unia Zentralschweiz

0848 651 651 zentralschweiz@unia.ch

Unia Zürich-Schaffhausen

0848 11 33 22 zh-sh@unia.ch

Sekretariati Qendror i Unia

031 350 21 11 info@unia.ch

Informata të mëtejme:
www.unia.ch/reinigung



**KKP e sektorit të pastrimit 2026–2029:
E vlefshme për të gjithë të punësuarit e
pastrimit në Zvicrën gjermane**

**Të drejtat tua në një
vështrim**

UNIA



Ndryshime të rëndësishme nga 1 janari 2026

Kontrata Kolektive e Punës (KKP) për sektorin e pastrimit në Zvicrën gjermane i rregullon kushtet tua të punës. Unia ka negociuar për ty një KKP të re, e cila nga viti 2026 sjell përmirësime të qarta:

Ndryshimet e rëndësishme shkurtimisht

- Pagat minimale rriten. Nga 2026 ti fiton 3% më shumë, nga 2028 edhe njëherë 2.5%.
- Pas përfundimit të shkollimit KKP, më 2026 do të ketë 5.4% më shumë pagë.
- Risi është, në rast sëmundje, janë të siguruar edhe të punësuarit me përqindje të vogël punësimi. Kjo paraqet një përparim të madh!

Falë sindikatës dhe KKP-së do të ketë edhe një pagë të 13 mujore, ditë festash të paguara dhe shumëçka tjetër.

Më të rëndësishmet shkurtimisht

Më shumë pagë!

Nga 1 janari 2026 ti dhe kolegët:et tu:a keni të drejtë në pagën minimale, si në vijim:

Kategoria e pagave	Nga 2026	Nga 2028
Pastrim-mirëmbajtje	Për orë 21.40	21.95
Pastrim-mirëmbajtje pas shkollimit KKP	Për orë 22.90	23.45
Pastrim special	Për orë 23.40	23.95
Pastrim special pas shkollimit KKP	Për orë 24.90	25.45
Pastrues:e spitali	Për orë 21.85	22.40
Pastrues:e spitali pas shkollimit KKP	Për orë 23.35	23.90
Pastrues:e automjete	Për orë 23.20	23.75
Pastrues:e automjete pas shkollimit KKP	Për orë 24.70	25.25
Pagë minimale fuqi pastruese pas certifikimit EBA	Në muaj 4'200.–	4'200.–
Pagë minimale fuqi pastruese pas certifikimit EFZ	Në muaj 4'700.–	4'700.–

Pagat e lartshënuara për orë janë paga bazike pa kompensim pushimesh (+8,33%), pa kompensim të ditëve festive (+1,5% deri 3,1% sipas kategorisë), pjesë e pagës së 13-të (+8,33%) si dhe shtesa tjera përkatëse.

Sëmundja, pushimet, orari i punës

Paga në rast sëmundjeje	Nëse je i sëmurë, ti merr mëditjen e sëmundjes nga dita e 3-të. Kjo vlen për të gjithë, pavarësisht përqindjes së punësimit.
Paga e 13 mujore	Të gjithë të punësuarit më gjatë se tre muaj, marrin një pagë të 13-të mujore.



Pushimet	Deri në moshën 20 vjeç: 5 javë Nga moshë 21 vjeç: 4 javë Nga moshë 50 vjeç dhe së paku 5 vite përvojë pune: 5 javë
Pushimi i lehonisë	Sipas ligjit: 16 javë me 80% pagë. Pas trueset, që nuk kanë të drejtë ligjore, falë KKP-së marrin 8 javë me 80% pagë
Ditë feste	9 ditë të paguara feste
Koha e udhëtimit	Nëse ti udhëton nga vendi yt i zakons-hëm i punës apo nga ndërmarrja tek klientët, duhet të paguhet koha e udhëtimit dhe shpenzimet e udhëtimit.
Ushqimi i drekës	Ti merr 16 franga kompensim ushqimi në ditë, nëse ti punon së paku 6 orë jashtë vendit tënd të zakonshëm të punës.
Veshmbathje pune	Ndërmarrja duhet që të pajisë me veshmbathje pune. Larjen dhe qepjen e veshmbathjes së punës duhet ta marrësh përsipër vet.
Kontrollet	Për të mënjeluar dumpingun në paga, ndërmarrjet do të kontrollohen.
Shkollimi KKP për më shumë pagë	Ti mund të bësh shkollim pa pagesë, që zgjat 80 orë. Pas kësaj do të ketë 1.50 franga më shumë për orë. Anëtarët e Unia përfitojnë kurse shtesë falas për gjuhën gjermane. Lajmërohu tek sekretariati i Unia!

Më shumë informata për të drejtat tua i gjen këtu:

